

# Njoftim për media

## Publikimi “Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2018”

**Tiranë, 07 Qershor 2018:** “Burrat dhe Gratë në Shqipëri” është publikimi i fundit i INSTAT, mbështetur nga UN Women me financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim, përmes të cilit vijnë pamje të realitetit shqiptar lidhur me popullsinë, shëndetin, arsimimin dhe vendimmarrjen, duke sjellë në fokus barazinë gjinore. Në konferencën me të njëjtin titull ishin të pranishëm Zv. Kryeministria, Znj. Senida Mesi, Z. Brian Williams, Koordinator i Përhershëm i OKB në Shqipëri si dhe Z. Heinz Habertheuer, përfaqësues i Agjencisë Austriake për Zhvillim në Shqipëri. Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj, vuri theksin mbi rëndësinë që ky publikim ka për institucionet shtetërore, biznesin dhe popullsinë.

Publikimi përmban dëshmi të rëndësishme për politikëbërësit dhe vendimmarrësit që punojnë në çështjet gjinore dhe përfshin një gamë gjithnjë e në rritje të statistikave gjinore në Shqipëri. “Nga këto risi të publikimit mund të përmendim përfshirjen e lëvizjeve të brendshme për burra dhe gra në kapitullin e popullsisë, si dhe disa të dhëna mbi familjet shqiptare me një analizë gjinore”, tha Ibrahimaj. Ndërsa, Koordinator i Përhershëm i OKB në Shqipëri, Z. Brian Williams, u shpreh se mbështetja që UN Women ka dhënë për INSTAT lidhur me këtë çështje është i një rëndësie të veçantë, duke adresuar kështu objektivin numër 5 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm globalë, arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Në fjalën e saj, Zv. Kryeministria, Znj. Senida Mesi, tha se qeveria dhe ajo personalisht janë tërësisht të angazhuar për përparimin e çështjeve gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas. Ajo vlerësoi këtë publikim si një instrument shumë të rëndësishëm për të ndërtuar politikën dhe strategjitë e duhura, duke shërbyer si një mekanizëm mbështetës për politikën ndërkombëtare për barazinë gjinore.

Nga ana tjetër, Përfaqësuesi i Agjencisë Austriake për Zhvillim në Shqipëri Z. Heinz Habertheuer, në fjalën e tij në konferencë vuri theksin mbi rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje. Sipas tij numri i grave në tregun e punës vazhdon të jetë në përqindje të ulëta, ndërsa pjesa më e madhe e grave dekurajohet për të punuar. Habertheuer u shpreh se mungesa e një shërbimi të strukturuar për kujdesin ndaj fëmijëve sjell mbingarkesë në veçanti për gratë e punësuar.

Publikimi ka analizuar statistikën e vendimmarrjes, të cilat tregojnë sesa të fuqishme po bëhen gratë në politikë dhe biznes, si dhe në jetën e përditshme. Konkretisht, në fund të vitit 2017, niveli i përfaqësimit të grave në parlament ka arritur përqindjen më të lartë 29 % që prej vitit 2013, dhe përqindja e grave drejtuese në ndërmarrje është 30 %. Përqindja e grave ndërmjet këshilltarëve të bashkive është 36,9 %. Pjesëmarrja e gruas në misionet diplomatike në vitin 2017, ka qenë në nivele të krahasueshme me burrat, ku përqindja e ambasadorëve gra ishte 27,0 % ndërsa gratë në pozicionin e Ministrit ishin 57,0 %.

Sipas publikimit “Burrat dhe Gratë në Shqipëri”, rezulton që lindin më shumë djem sesa vajza, por nga ana tjetër gratë jetojnë më gjatë sesa burrat. Përkatesisht, gratë jetojnë mesatarisht rreth 3 vjet më shumë sesa burrat. Shëndeti është një tjetër temë e trajtuar nga publikimi, ku vendoset theksi tek sëmundjet që prekin më tepër shqiptarët dhe abortet.

“Në Shqipëri si për burrat dhe për gratë, vijojnë të jenë “grupsëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut”, të cilat shkaktojnë 56,8 % të vdekjeve tek gratë dhe 50,7 % të vdekjeve tek burrat”, shkruhet në publikim.

Duke u ndalur tek shëndeti, Znj. Ibrahimaj, theksoi se “këto shifra duhet t’u shërbejnë politikëbërësve për të marrë vendime sa me të mira në lidhje me planifikimet buxhetore në shëndetësi. Siç shihet ndjehet dhe domosdoshmëria për të pasur një buxhet gjinor në vend ku politikat të jenë të fokusura edhe në implementimin e barazisë gjinore në praktikë”.

Abortet janë një tjetër aspekt i shëndetit kur vjen fjala për analiza gjinore. Të dhënat tregojnë se për çdo 5,9 lindje, ka ndodhur paralelisht edhe një abort, i kryer më së shumti në grupmoshat 20-34 vjeç, që në pjesën më të madhe të tyre janë spontane (77,4 %).

Kur vjen fjala për arsimin, tek shkollimi parauniversitar mbizotërojnë djemtë, por shkollimi i lartë është i dominuar nga vajzat me rreth 60%.

Gratë janë gjysma e popullsisë së këtij vendi dhe për rrjedhojë ato janë pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror në vendin tonë, ku politikat integruese dhe rritja e aksesit të tyre në vendimmarrje apo fusha të tjera të jetës duhet të jetë prioritet.

Prandaj dhe vetëdija jonë është se vetëm nëpërmjet një reflektimi objektiv bazuar në statistika, mund të arrihet një qasje e fuqizimit të grave dhe vajzave për të rrëzuar barrierat strukturore ndaj barazisë gjinore.

INSTAT është një institucion i pavarur publik, koordinator zyrtar i Sistemit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë, misioni i të cilit është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente, në kohë, të përshtatshme, të besueshme dhe të krahasueshme për vendimmarrësit, kërkuesit shkencor dhe arsimin në Shqipëri, si dhe në komunitetin ndërkombëtarë.

UN Women në Shqipëri punon ngushtë me qeverinë dhe shoqërinë civile për të krijuar dhe zbatuar ligjet, politikat, programet dhe shërbimet e nevojshme, për të përmirësuar statusin e grave dhe për të arritur standardet globale për barazinë gjinore.

Agjencia Austriake për Zhvillimit mbështet projekte dhe programe për të luftuar varfërinë, për të siguruar paqen dhe mjedisin, me një total prej 500 milion EUR për të përmirësuar kushtet e jetesës në shtetet në zhvillim.

*Linku i publikimit interaktiv “Burra dhe Gra në Shqipëri, 2018”:* <http://instat.gov.al/publikimi>